



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

- Kryesuesi -

15Nr. 413-1564/1

Lipjan, me 10. 02. 2012

Për :	Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, Drejtorive të Komunës së Lipjanit dhe Sektorit për informim.
Nga:	Kryesuesi i Kuvendit Lulzim Rrustemi
Lënda:	Dergimi i Rregullores për taksat, tarifat dhe gjobat komunale (për here te dyte me permiresim) te numrit rendor dhe paragrafit 2.3 dhe 2.4.



Në shtesë të kësaj shkrese ju dërgojmë për herë të dytë Rregulloren për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për taksat, tarifat dhe gjobat komunale 15 Nr. 413-1564 të datës 01. 02. 2012 me përmirësim të gabimeve teknike në nenin 1 dhe 5 ku duhet të ndryshohet numri rendor i cili është 775 dhe bëhet 755 si dhe përmirësimi i nenit 2 ku teksti i paragrafit 2.3 kalon në paragrafin 2.4, ndërsa teksti i paragrafit 2.4 kalon në paragrafin 2.3.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Duke u bazuar në dispozitat e nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/ L - 040, Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28 e datës 04. Qershor 2008, dispozitave të nenit 8 – 22 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal Nr. 03/L-049, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 27 e datës 03. 06. 2008, të nenit 9 dhe 17 të Statutit të komunës së Lipjanit 1Nr. 110-623 i datës 26. 09. 2008, Kuvendi i Komunës së Lipjanit në mbledhjen e mbajtur me 31. 01. 2012 miratoj këtë:

RREGULLORE

PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORES PËR TAKSAT TARIFAT DHE GJOBAT KOMUNALE 1NR. 413-755 E DATËS 03. 12. 2008

Neni 1

1.1 Në Rregulloren për taksat tarifate dhe gjobat komunale 1 Nr. 413 – 755 e datës 03.12.2008 në nenin 3 paragrafi 3.3 shuma e kreut të tabelës numër 14 nga 60 euro ndryshohet dhe bëhet 80 euro.

1.2 Në të njëjtin nen te tabela nr. 14 në rreshtin e pestë emërtimi: “telekomunikimet-shërbimet e internetit për shërbime me pije” me shifrën e veprimtarisë 6420 fshihet.

Neni 2

2.1 Në nenin 5 në paragrafin 5.4 tarifa në numrin rendor 3 rritet nga 3 në 8 €.

2.2 Në të njëjtin nen dhe paragraf në emërtimin e dokumentit në numrin rendor 5 shtohen fjalët “jashtë vendit mbajtës të familjes” ndërsa shuma e tarifës për këtë dokument nga 3 € bëhet 8 €.

2.3 Në të njëjtën nen dhe paragraf numri rendor 6 i tabelës fshihet, ashtu që numrat rendor në vijin ri renditen.

2.4 Në të njëjtin paragraf të këtij neni shtohet kolona në tabelë me numër rendor 14 me emërtimin e dokumentit : “ Vërtetim për shtesa fëmijërore për personat që punojnë jashtë vendit” me tarifë në lartësi prej 8 €.

2.5 Në të njëjtin nen paragrafi 5.4 në numrin rendor 7 të tabelës tarifa ndryshohet nga 5 euro në 7 euro, dhe pas ri renditjes bëhet kolona numër 6.

2.6 Në të njëjtin paragraf të këtij neni në numrin rendor 12 të tabelës te emërtimi i dokumentit shtohen fjalët : “prej sipërfaqes 01- 100 m², ndërsa tarifa nga 15 euro bëhet 25 euro”, dhe pas ri renditjes bëhet kolona numër 11.

2.7 Në të njëjtin paragraf shtohet kolona me numër rendor 15 me emërtimin si vijon: “Certifikimi i objektit mbi plotësimin e kushteve minimale- teknike për ushtrimin e veprimtarisë afariste prej sipërfaqes 100 m² e më tepër”, me lartësi të tarifës prej 50 euro.

Në kuadër të nenit 16 paragrafi 16.2 pika 2 e tabelës ndryshohet tarifa për m² nga 3 € në 1 €.

Neni 3

3.1 Në nenin 7 paragrafi 7.2 emërtimi i shërbimit në numrin rendor 1 ndryshohet dhe thekson: “Ceremonia e kurorëzimit në zyrat e vendit”, ndërsa shuma e tarifës nga 8 bëhet 10 euro.

3.2 Në të njëjtin paragraf në numrin rendor 2 emërtimi i shërbimit në numrin rendor 2 ndryshohet dhe thekson:

“ Ceremonia e kurorëzimit jashtë zyrave të vendit “ shuma e tarifës nga 30 bëhet 70 euro, ndërsa fjalët: “dhe për shpenzime të transportit me automjet zyrtar nga 0.5 euro për çdo kilometër të kaluar” fshihen.

Neni 4

Në nenin 12- tarifat rregullative për zhvillimin dhe ruajtjen e infrastrukturës, tabela nën a) kompensimi për rregullimin dhe kyçjen në infrastrukturën komunale fshihet, ndërsa në vend të saj formulohet tabelë e re me këtë përmbajtje:

Nr	Destinimi i objektit	Zona ndërtimore	Njësia	Shuma në €
1	Sipërfaqja e shtëpisë familjare për banim	II	m/2	1.50
		III	m/2	0.90
		IV	m/2	0.70
2	Sipërfaqja e shtëpisë familjare për afarizëm	II	m/2	2.40
		III	m/2	1.80
		IV	m/2	1.50
3	Sipërfaqet e destinuara për banim në objektet kolektive	I	m/2	5.00
		II	m/2	3.00
		III	m/2	2.00
		IV	m/2	1.50
4	Sipërfaqet e destinuara për afarizëm në objektet kolektive të banimit dhe sipërfaqet e objekteve afariste	I	m/2	8.00
		II	m/2	6.00
		III	m/2	3.00
		IV	m/2	2.50
5	Objektet për arsim, shëndetësi, kulturë, sport të karakterit privat		m/2	5.00
6	Sipërfaqet e ndërtuara në zonën e aeroportit		m/2	12.00

Neni 5

Numrat e neneve nga neni 18 i Rregullores për taksat tarifat dhe gjobot komunale 1 Nr. 413 – 755 i datës 03.12.2008 rriten për një numër.

Neni 6

Kjo rregullore hynë në fuqi 8 ditë pas publikimit në faqen elektronike të komunës.

15 Nr. 413-1564

Lipjan, më 01. 02. 2012

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

KRYESUESI
Lulzim Rrustemi

